



FEDERATA ATLETIKE E KOSOVËS

RREGULLORE E PUNËS SË
KËSHILLIT MBIKËQYRËS

Prishtinë, Nëntor 2022

Në bazë të nenit 31 të Statutit të Federatës Atletike të Kosovës, Kuvendi i Federatës Atletike të Kosovës, në seancën e mbajtur më 30 nëntor 2022, miratoi këtë:

RREGULLORE TË PUNËS SË KËSHILLIT MBIKËQYRËS

Neni 1

Me këtë rregullore përcaktohen procedurat e punës dhe obligimet e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës.

Këshilli Mbikëqyrës si organ i Federatës Atletike të Kosovës, kryen punët dhe detyrat, në përputhje me dispozitat e Statutit të Federatës Atletike të Kosovës dhe kësaj rregulloreje.

Mbikëqyrjen e punës dhe veprimtarisë së Federatës e kryen Këshilli Mbikëqyrës.

Neni 2

Kryetari, anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës zgjidhen nga Kuvendi sipas procedurës së parashikuar për zgjedhjen e anëtarëve të Bordit Ekzekutiv në kuvendin zgjedhor. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës zgjidhen nga jashtë përbërjes së organeve të Federatës.

Këshilli Mbikëqyrës ka një kryetar dhe dy anëtarë.

Mandati i anëtarëve të këshillit mbikëqyrës zgjat katër vjet.

Neni 3

Këshilli Mbikëqyrës funksionon në seanca të mbajtura të paktën një herë në vit. Këshilli Mbikëqyrës mund të marrë një vendim të vlefshëm nëse janë të pranishëm të gjithë anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës.

Këshilli Mbikëqyrës i raporton Kuvendit.

Neni 4

Këshilli Mbikëqyrës mbikëqyr dhe kontrollon zbatimin e ligjshmërisë në punën dhe veprimet materiale e financiare të Federatës.

Kryen kontroll mbi përdorimin e fondeve dhe shqyrton ligjshmërinë e veprimeve dhe të bilancit të Federatës Atletike të Kosovës.

Analizon dhe shqyrton pasqyrën e fondeve të Federatës Atletike së paku një herë në vit.

Neni 5

Nëse Këshilli konstaton se në punën e organeve të Federatës Atletike të Kosovës janë bërë shkelje ligjore, janë bërë keq përdorime në mjete financiare, Këshilli Mbikëqyrës kërkon nga kryetari që të mbahet mbledhja e Bordit, në mënyrë që të analizohen dhe vërtetohen shkeljet dhe keq përdorimet.

Neni 6

Këshilli për gjendjen e konstatuar dhe mendimin lidhur me masat e njofton kryetarin e Federatës Atletike të Kosovës, organet e Bordit dhe Kuvendin e Federatës Atletike të Kosovës dhe propozon masat për përmirësimin e gjendjes në suaza të dispozitave të Statutit dhe

akteve të tjera të Federatës Atletike të Kosovës, në veçanti ndjek realizimin e planit financiar, duke propozuar masa gjegjëse, të cilat janë të obligueshme.

Neni 7

Mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës i cakton kryetari në bazë të vlerësimit të Këshillit për veprimtarinë e Bordit Ekzekutiv;

Neni 8

Këshilli Mbikëqyrës merr vendime me shumicë votash.

Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës nuk kanë të drejt të abstenojnë nga votimi.

Neni 9

Kryetari i Këshillit Mbikëqyrës ka të drejtat dhe detyrat si vijon:

1. Organizon dhe konvokon mbledhjen e Këshillit Mbikëqyrës
2. Kryeson me mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës
3. Kujdeset për sigurimin e transparencës në punën e Këshillit Mbikëqyrës
4. Kryen edhe detyra të tjera të caktuara me Rregulloren mbi Punën e Këshillit Mbikëqyrës.

Në seancën e Këshillit Mbikëqyrës mbahet procesverbali të cilin e mban Sekretari i Përgjithshëm i Federatës Atletike të Kosovës.

Neni 10

Sekretari i Përgjithshëm i Federatës Atletike të Kosovës është i obliguar të njoftoi Këshillin mbikëqyrës me shkrim lidhur me mbledhjen e Bordit me rendin e ditës, materialet e përgatitura për mbledhje dhe vendimet që janë mbajtur në mbledhje.

Neni 11

Në mos respektimin e kësaj Rregulloreje nga ana e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës, do të merren masa adekuate disiplinore.

Neni 12

Kjo Rregullore hynë në fuqi në ditën e miratimit të saj nga Kuvendi.

Prishtinë, më
30.11.2022

Kryetari i FAK-ut
Halil Sylejmani

